



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 63 Datë 31/05/2023

“Për emërtimin e rrugëve, shesheve, territorëve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë: “Emërtimi i rrugës nga Lapidari në Arras deri në Sinë të Epërme” me emrin “Pal Kastrioti” njësia Administrative Arras”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9/1.7 gërma “b” dhe nenit 54, gërma “ll”, neni 55 pika 2 të ligjit nr.139/2015, për “Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak mori ne shqyrtim kërkesën për emërimin e rrugës “Pal Kastrioti ” nga Lapidari në Arras deri në Sinë të Epërme, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **31.05.2023** , me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës nga *Lapidari në Arras deri në Sinë të Epërme, në emrin “Pal Kastrioti”, Njësia Administrative Arras.*
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi u shpall me datë **31.05.2023**.

